



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 14, 15 dhe 22 maj 2018.
2. Seancë dëgjimore publike në kuadër të Ditës Botërore të Luftës kundër Duhanit me institucionet përkatëse, për të parë zbatueshmërinë e ligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Roland Xhelilaj, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Klotilda Bushka dhe Vilma Bello (zëvendësuese).

Mungojnë:

Petrit Vasili, Bardh Spahia, Arben Kamami, Adelina Rista, Vangjel Tavo, Grida Shqina, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Halim Kosova dhe Floida Kërpaçi.

Të ftuar:

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Erol Çomo – Përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Antoneta Njehrrrena – Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Eltar Deda – Përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor
Genc Byrazeri - Nëndrejtor i ISHP-së
Genta Qirjako – Shefe e Departamentit të Promocionit Shëndetësor në ISHP

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Ju kërkoj ndjesë që pritët, por ndodhi për shkak të rrethanave jo të përshtatshme në funksionimin e komisioneve për shkak të bojkotit të opozitës.

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 14, 15 dhe 22 maj. A keni ndonjë kundërshtim apo sugjerim? Nuk keni.

Atëherë, miratohen.

Sot do të zhvillojmë një seancë dëgjimore publike në kuadër të Ditës Botërore të Luftës kundër Duhanit, që, në fakt, është në datën 31 maj, por po e bëjmë sot për shkak të angazhimeve të shumta në Kuvend. Sigurisht, kjo seancë dëgjimore do të zhvillohet me institucionet përkatëse për të parë zbatueshmërinë e ligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”. Në komision kemi të ftuar zëvendësministren, Mira Rakacolli, kryeinspektorin Shtetëror Shëndetësor, Eltar Deda, Erol Çomo, Genc Byrazeri dhe Genta Qirjako. Ju uroj të gjithëve mirëseardhjen!

Fillojmë me dëgjuesin. Fjalën e ka zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli - Mirëdita të gjithëve!

E nderuar zonja Spiropali,

Të nderuar deputetë,

Duhani është i vetmi shkak i eliminueshëm për shumë sëmundje jo të transmetueshme, të cilat zënë vendin e parë si shkaktare të vdekjes dhe të sëmundshmërisë, si dhe është shkak kryesor i kancerit të rrugëve të frymëmarrjes. Për këtë arsye lufta ndaj duhanit tashmë është kthyer prej dekadash në sfidë botërore të të gjitha sistemeve shëndetësore dhe jo vetëm.

Nëse do të flisnim me gjuhën e shifrave, Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaroi se nga duhani vdesin në vit 7 milionë njerëz, nga të cilët 900 mijë janë duhanpirës sekondarë. Pra, këto shifra e kthejnë duhanin në një epidemi botërore. Mbi 80% e duhanpirësve, nga 1 miliard që janë në mbarë botën, jetojnë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme ekonomike. Në Shqipëri 1 në 4 vdekje nga sëmundjet kronike shkaktohet nga duhanpirja, gjithashtu, 1 në 4 vdekje nga sëmundjet kardiovaskulare ka në bazë duhanpirjen. Për kancerin këto të dhëna negative janë edhe më të larta, duke bërë që mbi 83% e vdekjeve të vijnë nga kanceri i mushkërive. Këto të dhëna janë nxjerrë nga raporti shëndetësor kombëtar, bazuar në gjendjen shëndetësore të popullsisë shqiptare në vitin 2014.

Në vitin 2003 në lidhshëm me Organizatën Botërore të Shëndetësisë u nënshkrua Konventa Botërore në Luftën kundër Duhanit, Konventë të cilës Shqipëria iu bashkua në vitin 2006. Në frymën e kësaj Konvente u morën edhe aktet ligjore, që rregullojnë marrjen dhe

zbatimin e masave në këtë luftë, që shprehen në ligjin nr. 9636, datë 6 nëntor 2006, i ndryshuar tashmë disa herë.

Strategjia kombëtar e shëndetit, e shkruar për herë të parë dhe lançuar në vitin 2017, mbështetet në disa programe, ndër të cilat: ai sëmundjeve jo të transmetueshme dhe i kancerit ka, ndërmjet të tjerave, në fokus edhe eliminimin duhanit në përputhje me Konventën e sapopërmendur. Në dhjetor të vitit 2017 parlamenti shqiptar iu bashkua programit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, ku objektivi 3/a ka të bëjë me luftën për një botë pa duhan në vitin 2030.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e ushtron rolin e saj të përcaktuar në dokumente nëpërmjet dy organeve të varësisë: Institutit të Shëndetit Publik dhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Këto struktura të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë rol parësor në parandalimin dhe veprimin ndaj konsumit të duhanit. Parandalimi është pjesë e aktivitetit të Institutit të Shëndetit Publik dhe veprimi ndaj konsumit të duhanit në vende publike të mbyllura kontrollohet nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Në Konventën kundër Duhanit përcaktohen drejtimet kryesore të luftës ndaj duhanpirjes, të cilat njihen në botë me akronimin EMPOWER, që në shqip janë: monitorimi i përdorimit të duhanit, mbrojtja e personave nga duhanpirja pasive, ofrimi i ndihmës për lënien e duhanit, fushata ndërgjegjëse mbi dëmet e duhanit, ndalimi i publicitetit apo promocionit të duhanit, si dhe rritja e taksave të duhani. Pra, janë 6 drejtime të përcaktuara në këtë Konventë dhe të gjitha vendet që e kanë nënshkruar këtë Konventë e zhvillojnë luftën e tyre në këto drejtime, si dhe ndjekin ecurinë e suksesit ose të jokusksesit duke parë indikatorë sipas këtyre drejtimeve.

Le t'i shikojmë këto si janë në Shqipëri:

Monitorimi i përdorimit të duhanit

Raporti i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, botuar në vitin 2014, raporton prevalencën e duhanpirjes ditore në Shqipëri te personat mbi 15 vjeç, 48% të meshkujve dhe 5% të femrave, në total 26% dhe reflekton në këto të dhëna studimet kombëtare të viteve 2002 dhe 2009. Ndërkohë studimi kombëtar i bazuar në popullatën me akronimin GPS-ë, 15-65 vjeç i vitit 2014 konfirmon prirjen e dukshme për rritjen e duhanpirjes së femrave, që ka shkuar mbi 10%, sidomos mes atyre më të arsimuara dhe që jetojnë në qytete, por një frenim të epidemisë së duhanpirjes te meshkujt, që shkon 43%. Pra, po t'i krahasojmë shifrat e raportuar nga ato të vitit 2009, ka një rënie.

Instituti i Shëndetit Publik për të monitoruar situatën e duhanpirjes ka disa studime në dorë, ka bërë disa, por ka edhe disa të tjera. Është kryer studimi demografik dhe shëndetësor,

ai që quhet ADHS, i bërë në vitin 2009; sjelljet e rrezikshme tek të rinjtë janë dy herë, në vitet 2005 dhe 2009; sjelljet e shëndetshme të fëmijët e moshës shkollore, edhe për këtë janë bërë dy herë studime, në vitet 2010 dhe 2014; studimi global i duhanit tek të rinjtë i bërë në vitin 2015. Të dhënat e këtij studimi janë raportuar edhe në Qendrën Ndërkombëtare të Kontrollit të Sëmundjeve, me qendër në Atlanta. Kjo ka përfunduar studimi me akronimin ADHS, shifrat e të cilit do të dalin në vjeshtën e këtij viti dhe që do të jenë ato mbi të cilat ne do të gjykojmë akoma më mirë se si ka shkuar trendi i përdorimit të duhanit në të gjitha grupmoshat e popullsisë.

Unë i kam këtu të gjitha rezultatet e studimeve, nëse do të ketë ndonjë interes për numra. Konkluzionin ynë është se monitorimi në Shqipëri bëhet mirë.

Mbrojtja e personave nga duhanpirja pasive.

Tashmë kjo sanksionohet me ligj ndalimi i pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura. Zbatimi i tij, kontrollet e vazhdueshme dhe marrja e masave në përputhje me këtë ligj, në rast moszbatimi, e garantojnë vënien në jetë sa më mirë të kësaj pike.

Ofrimi i ndihmës për lënien e duhanit

Në vendin tonë Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, në paketën bazë të shërbimit, që duhet të ofrojë mjeku i familjes, ka përfshirë edhe këshillimin dhe informimin mbi lënien e duhanit për popullsinë, pra të atë grup popullsie që ky mjek mbulon.

Spektori i abuzimit me drogat dhe ai i promocionit në Institutin e Shëndetit Publik kanë bërë vazhdimisht trajnime të mjekëve të përgjithshëm për këto probleme. Në mbledhjen e fundit të Komunitetit Kombëtar Intersektorial, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për mbrojtjen nga duhani u vu në dukje mungesa e linjës direkte telefonike për këshillimin krahas ekzistencës së asaj për njoftimin e pirjes së duhanit në ambientet e mbyllura dhe u përcaktuan detyrat për organizimin sa më të shpejtë të saj. Prezenca në tregun farmaceutik të produkteve me bazë nikotinën, është një tjetër mënyrë që ndihmon në lënien e duhanit.

Fushata ndërgjegjëse mbi dëmet e duhanit dhe parandalimin e duhanpirjes.

Siç e thashë edhe më parë, ky është një subjekt, të cilin e ka në vëmendje Instituti i Shëndetit Publik, me sektorin e tij të dedikuar (shefen e së cilës e kemi prezent edhe këtu në komision). Në planin e promocionit shëndetësor të viteve 2017-2022, Instituti i Shëndetit Publik, si institucion varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, objektivi $\frac{1}{4}$ shënon: “Uljen me 10% të duhanpirësve aktual në popullatën 15-64 vjeç, uljen me 15% të duhanpirësve meshkuj në popullatën 15-64 vjeç, uljen në 5% të duhanpirësve femra dhe uljen e tendencës së fillimit të duhanpirjes të fëmijët e moshës shkollore 11-15 vjeç”. Për t’i arritur këto gjëra çdo

vit Instituti i Shëndetit Publik organizon fushata kombëtare ndërgjegjësimi lidhur me ndikimin e duhanit dhe intensiteti i këtyre fushatave ka ardhur duke u rritur.

Çfarë aktivitete janë zhvilluar? Është bërë trajnim kombëtar i përvitshëm me specialistët e promocionit shëndetësor për përditësimin e njohurive mbi çështjet e lidhura me duhanpirjen në organizimin e fushatave kombëtare dhe lokale “Jo duhanit”. Konkretisht, janë zhvilluar trajnime me temë: “Ndikimi i duhanit në shëndet” në rrethet: Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier dhe Vlorë, me specialistë të promocionit dhe ato të Inspektoratit Shëndetësor.

Në nivel rrethi është trajnuar personeli pedagogjik dhe shëndetësor në shkolla mbi duhanpirjen dhe pasojat që sjell ajo në shëndet, si pjesë e paketës prej 12 modulesh të Organizata Botërore e Shëndetësisë për mjekët dhe infermieret e shkollave.

Është bërë trajnimi në nivel rrethi i personelit shëndetësor në kujdesin shëndetësor parësor me temë: “Cilat janë ndërhyrjet për lënien e duhanit”, po sipas modulit të ofruar nga OBSH-ja në Tiranë dhe nëpër rrethe.

Në mënyrë të përvitshme janë organizuar fushata kombëtare dhe lokale të komunikimit “Jo duhanit”. Sektori i Abuzimit me Substancat në Departamentin e Promocionit ka organizuar fushata sensibilizuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Tiranës.

Fushatat e vitit në vazhdim kanë qenë komplekse

Aktualisht është duke u zhvilluar një fushatë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Tiranës dhe Durrësit, konkretisht në shkollën e mesme “Petro Nini Luarasi” dhe gjimnazin “Naim Frashëri” në qytetin e Durrësit.

Për rritjen e efektivitetit, në funksion të sensibilizimit dhe informimit të të rinjve, natyrisht do të ishte më rezultative që këto fushata të shtriheshin në të gjithë vendin. Ne e kemi si objektiv, por kërkohet një suport më i madh financiar.

Nga ana tjetër, nëpërmjet paketave të duhanit, dhe paralajmërimeve përkatëse shëndetësore, që bëhen në këto paketa, lidhur me dëmet që mund t'i shkaktojnë vetes apo të tjerëve me sjelljen e tyre të rrezikshme, përsëri bëhet një lloj promocioni për ndalimin e duhanit.

Bazuar në ligjin nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, Radiotelevizionit Publik Shqiptar ka detyrimin për të transmetuar 90 minuta çdo muaj programe të ndërgjegjësimit për efektet e dëmshme të duhanit për shëndetin e çdo individit. Vitin e kaluar specialistë të departamentit të promocionit të ISHP-së kanë dalë 15 herë në medien vizive dhe 6 në atë të shkruar.

Ndalimi i publicitetit apo promocionit të duhanit

Në Shqipëri ligji ndalon reklamat, promocionet apo sponsorizimet e çfarëdolloj natyre lidhur me produktet e duhanit. Për këtë jemi të gjithë dëshmitarë që sot në Shqipëri nuk bëhet asnjë lloj promovimi i tillë

Rritja e akcizës

Eksperienca europiane dhe amerikane kanë treguar se është nga më efikasat në uljen e numrit të duhanpirëseve. Për shembull, viti 2009 në Amerikë shënoi vitin kur akciza u rrit më shumë. Këtë vit konsumi i duhanit ra më poshtë se çdo vit tjetër, duke filluar që nga viti 1932, dhe numri i thirrjeve telefonike në linjën e dedikuar këshillimit për lënien e duhanit u rrit 30% në krahasim me një vit më parë. Studimet e botuara në revista tregojnë se për 10% të rritjes së çmimit të cigares, ulet 2% numri i përdoruesve të rritur dhe 4% ai të rinjve. Natyrisht, të gjithë e dimë se edhe në Shqipëri janë bërë hapa në këtë drejtim, studimet e fundit do ta tregojnë, këto që përmenda më parë, në qoftë se do të kemi ulje. Këto janë ato që kemi bërë.

Dua të flas pak për zbatimin e ligjit.

Zbatimi i ligjit që përmenda u ndryshuan në vitin 2013 dhe në vitin 2014. Këto ndryshime rezultuan në parashikimin e 3 niveleve të gjobave, ku u përfshinë trupa të tjerë inspektues sipas fushës së veprimi u shënuar roli i inspektoratit qendror si bashkërendues për këto dhe u shënuar detyrimi i Radiotelevizionit Publik. Natyrisht që të gjitha këto janë masa shtrënguese në favor të uljes së duhanpirjes.

Në periudhën 1 janar 2017 deri më 31 dhjetor 2017, janë kryer rreth 16 mijë inspektime për zbatimin e ligjit, ku nga këto inspektime janë marrë 312 masa. Vetëm për periudhën janar-prill 2018 janë kryer 15.162 inspektime dhe janë marrë 132 masa, ku vetëm në tri ditët e fundit të muajit maj janë bërë 646 inspektime dhe është marrë vetëm një masë. Çfarë do të thotë kjo?! Kjo do të thotë se janë bërë shumë inspektime dhe është ulur numri i masave, që do të thotë se njerëzit kanë filluar të ndërgjegjësohen më shumë për pirjen e duhanit.

Nuk duhet të harrojmë që ndryshimet në mentalitet duan një kohë relativisht të gjatë, të cilat, para se të gjithash, duhet të priren nga ndryshimet në mentalitetin e ofruesve të shërbimit shëndetësor publik, me mospirje të duhanit nga ata vetë, si dhe në ofrimin e asistencës së nevojshme për ata që duan të heqin dorë nga ky ves.

Pavarësisht se zbatimi i ligjit në fjalë është detyrë e një numri jo të paktë inspektoratesh dhe organesh të tjera ligjzbatuese, si: organet e administratës doganore dhe organeve tatimore, inspektoratit që mbulon fushën e arsimit, inspektoratit që mbulon fushën e punës, inspektoratit të sigurisë ndaj zjarrit, Policisë së Shtetit apo policisë bashkiake ose komunare, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në realitet zbatimi i ligjit është ndjekur vetëm nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Me të gjitha vështirësitë e hasura, puna për zbatimin e ligjit konsiderohet e suksesshme, fakt i shprehur në vitin 2015 nga OBSH-ja në dhënien e çmimit në Ditën Botërore pa Duhan, si edhe në citimin e progresraportit të Komisionit European për Shqipërinë në vitin 2016, ku Komisioni European përmend edhe zbatimin e ligjit me fjalinë “Për kontrollin e duhanit, ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit është zbatuar”. Fakti që citimi në kapitullin 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike” të progresraportit të Komisionit European në vitin 2015 për Shqipërinë ishte: “Ligji për ndalimin e duhanit në ambientet e mbyllura rezultoi efektiv”, tregon se zbatimi i ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet duhan, i ndryshuar, është i suksesshëm dhe është në rrugën e duhur.

Raporti i OBSH-së në vitin 2017 e rendit Shqipërinë në vendet që ka pasur arritjet më të larta lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit dhe zbatimin e legjislacionit kundër duhanit dhe zbatimin e penaliteteve për reklamimin e duhanit.

Në datën 2 maj të këtij viti u mbledh Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit, i cili vendosi: ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit në shëndet jo vetëm përmes teksteve, siç ka qenë deri tani, por edhe nëpërmjet fotografive dhe paraqitjen e tyre në mbledhjen e ardhshme të Komitetit; ngritjen e një grupi tjetër pune, i cili do të kryejë konsultime publike me përfaqësues të kompanive prodhuese dhe importuese të produkteve të duhanit në vend, në mënyrë që të ketë një periudhë përgatitore deri në datën e importimit dhe prodhimit të detyruar të produkteve me paralajmërimet shëndetësore me figura, si dhe ngritjen e një grupi pune për të parë nëse ka nevojë që ligji i duhanit të ndryshojë, duke marrë parasysh disa nga çështjet me të cilat është përballur ISHSH-ja gjatë zbatimit të tij, siç janë: cigarja elektronike, përdorimi i shishave, reklamimi i fshehur, si dhe shkelësit e përsëritur të ligjit. Ne e dimë që cigarja elektronike dhe shisha janë me efekte të dëmshme dhe ligji aktual nuk i përfshin masat që duhen marrë për eliminimin e përdorimit të këtyre substancave. Në zbatim të këtyre vendimeve, ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale ka nxjerrë urdhrat përkatës. Këto grupe kanë bërë mbledhjet e tyre të para dhe planin e punës në zbatim të urdhrave të lëshuar.

Ju faleminderit!

Elisa Sporopali – Faleminderit, zonja Rakacolli!

Zoti Deda, keni diçka për të shtuar?

Eltar Deda – Jo, nuk kam.

Elisa Spiropali – Dakord. Materiali ishte shterues, kështu që, në qoftë se nuk ka gjë për të shtuar, vazhdojmë me pyetjet e deputetëve.

Flamur Golemi- Faleminderit, Elisa!

Falënderoj doktoreshë Mirën. Në fakt ne jemi në ato raste, ku zbatueshmërinë e ligjit e gjejmë në terren.

Sot dua të flas edhe si punonjës në fushën e shëndetësisë, por edhe si përfaqësues i komunitetit të zonës time. Ky ligj ka filluar të zbatohet, ne e shohim të gjithë dhe kemi vënë re edhe ndryshimin, ku vlen të falënderohet edhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor për punën që ka bërë deri tani.

Doktoresha përmendi falënderimet dhe raportin vlerësues të OBSH-së dhe të Bashkimit Europian.

Unë dua një informacion nga kryeinspektori lidhur me inspektimet nëpër zona të tjera të Republikës, duke përfshirë Tiranën dhe qendrën, pasi të gjithë e shohim që këtu ligji po zbatohet. Si është zbatueshmëria e ligjit në terren, cila është pika e dobët dhe çfarë duhet të ndryshohet, të paktën në periferi? Faleminderit!

Elisa Spiropali – Fjalën e ka Ilir Pendavinji.

Ilir Pendavinji –Faleminderit, zonja nënkryetare!

Fjalën time dua ta nis me një falënderim për institucionet që janë prezentë sot. Sot është një ditë sinjifikative lidhur me luftën kundër përdorimit të duhanit.

Unë kam qenë pjesë e Komisionit të Shëndetësisë në momentin kur u miratua ligji antiduhan, i rregulluar, dhe është e vërtetë që për miratimin e këtij ligji janë bërë hapa shumë të mëdha.

Dua ta vlerësoj punën e Inspektoratit, të doktor Eltarit, që e kam mik të vjetër, të cilin e shoh se si punon dhe përkushtohet për ndjekjen me rigorozitet të të gjitha detyrave të lëna për pjesën e luftës kundër duhanit.

Një problem që unë shoh dhe jam dakord edhe me doktor Flamurin, është se kemi vërtet shumë punë për të bërë në pjesën periferike, në zonën e fshatrave, ku kontrolli që duhet të ushtrojë Inspektorati nuk mund të bëhet, sepse është e pamundur që ne të kemi një inspektor për një fshat, pasi kushtet tona nuk na e lejojnë.

Jam dakord me zonjën Rakacolli, e cila thotë që të rriten fondet për promovimin e luftës kundër duhanit dhe kjo alternohet edhe me punën e mirë që bën Inspektorati në terren, së bashku me promocionet antiduhan, që mund të bëhen në media. Unë kam parë shumë filma indianë që shkëputen në mes dhe fusin promocion kundër duhanit dhe mendoj se edhe në ligjin tonë mund të vihet një rregull, që në filma të ndryshëm, në kanalet shtetërore të fusim një promocion, i cili të jetë i detyrueshëm. Edhe ne si komision duhet të bëjmë disa amendime, të cilat mund të ndikojnë mirë në ligj. Faleminderit!

Elisa Spiropali – Fjalën e ka deputeti Nuri Belba.

Nuri Belba – Unë ju falënderoj për dëgjuesën e sotme, sepse është me shumë rëndësi, sidomos për parandalimin e këtij fenomeni që shkakton shumë probleme me shëndetin. Dua të di më shumë se çfarë mund të bëjë Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit për parandalimin e këtij fenomeni, sepse ne e kemi parë dhe jemi të vetëdijshëm për problemet që shkakton në shëndet. Ne e kemi parë që ky fenomen fillon në moshë shumë të re dhe sensibilizimi i Ministrisë së Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të ishte një gjë e mirë, e cila do të sillte më shumë informacion në shkolla, pse jo të organizohet edhe një takim me prindërit dhe me nxënësit.

Pyetja e dytë lidhet me akcizën. Sa është ulur duhanpirja në raport me vendosjen e akcizës në Shqipëri, sepse, me sa di unë, kjo është reflektuar në çdo paketë fiskale të viteve të shkuara.

Lidhur me atë që thanë parafolësit për zonat rurale, ligji është i njëjtë për të gjithë, por ndoshta nuk ka sa duhet kontroll nga ana e ISHSH-së. Në qendrat urbane të zhvilluara ndërgjegjësimi ka arritur në masën e duhur, por në zonat, ku edhe ne përfaqësojmë, ka ende probleme. Faleminderit!

Elisa Spiropali – Unë dua të bëj një ndërhyrje, pastaj fjalën e ka zonja Xhembulla.

Nga eksperiencia që unë kam parë në një shkollë të mesme në Kanada, ku kam qenë në kolegji, ishte e detyruar me ligj që një poster i madh të vendosej në hyrje të çdo shkolle. Në fakt, ishte një poster shumë i frikshëm, sepse sa herë që e shikoje, të hiqte krejtësisht dëshirën për të pirë cigare. Unë isha 16 vjeç në kolegji, por, sigurisht, duhanin e fillojnë edhe më herët. Në çdo qendër shëndetësore të kolegjit, në dyert e klasave, si dhe në hyrjen kryesore të shkollës kishte një poster të madh, që tregonte mushkëritë e një njeriu të katandisura keq nga duhani. Ishte e parashikuar në ligj që në çdo gjimnaz, shkollë, kolegji e me radhë, të vihej një poster i tillë. Unë mendoj se duhet bërë diçka e ngjashme në dyert e shkollave të mesme, në dyert e universiteteve, në dyert e qendrave shëndetësore, ku diku e kam parë dhe diku jo, por duhet të jetë e detyrueshme që në një qendër shëndetësore, nuk ka rëndësi nëse është në një fshat të largët apo në qytet, të ketë një poster, i cili dëshmon dëmin që të shkakton duhani.

Unë jam dakord me atë që tha zoti Pendavinji, që Inspektorati ka bërë një punë të shkëlqyer, sepse edhe nëpër qendrat e qyteteve dhe nëpër kafenetë ka ndryshuar kultura, nuk lejohet të pihet duhan, ku më përpara pihej në çdo mjedis. Megjithatë, në zonat e largëta mbetet problem. Për njerëzit është më mirë ta parandalosh dhe ta edukosh sesa të vijë inspektori të vejë gjobën. Unë mendoj se në ligj duhet lënë një hapësirë për të përfshirë fushatën kundër pirjes së duhanit.

Fjala për zonjën Xhembulla.

Almira Xhembulla- Faleminderit, zonja nënkryetare!

Shumë faleminderit doktoreshë Mirës për të gjithë informacionin dhe ekipit për të gjithë punën e mirë që kanë bërë. Pa diskutim që nisma ligjore e luftës kundër duhanit mendoj se është një nga nismat, që ne si përfaqësuese të Partisë Socialiste na bënë të ndjehemi shumë mirë, sepse ka qenë një ndër ligjet dhe nismat ligjore më të mirat që janë ndërmarrë, më relevantet dhe më të zbatueshmet deri tani. Duke e krahasuar edhe me vendet e rajonit, zbatimi i kësaj nisme na bënë të ndjehemi mirë.

Unë bashkohem me mendimin e disa prej kolegëve, që duhet të vazhdojmë me të njëjtin agresivitet për zbatimin e ligjit, sidomos në ambientet e institucioneve publike, nuk flas për bare, për lokale, por për zyrat e administratës së shtetit apo për institucione të tjera. Nuk po flas për qendrat urbane, por për periferitë, ku zyrtarë jo shumë të përgjegjshëm në këtë aspekt japin një model negativ tek të tjerët. Kështu, duke e falënderuar Inspektoratin, them se duhet të jemi shumë agresivë, sidomos në këto ambiente, sepse ata janë një model për zbatimin e ligjit dhe duhet të jenë të kujdesshëm në këtë nismë.

Patjetër që duhet të jemi shumë më intensivë edhe për sa u përket fushatave të ndërgjegjësimit dhe të dhënies së informacionit në bashkëpunim me sistemin arsimor, por jo vetëm. Unë kam parë që janë organizuar shumë aktivitete edhe në zona që nuk janë shumë afër, por do të duhet të bëhen edhe më shumë. Për shembull, unë përfaqësoj zonën e Dibrës, e cila nuk është shumë afër. Aty vihet re zbatimi i ligjit dhe kryesisht të rinjtë janë të angazhuar për të dhënë informacion dhe për të organizuar aktivitete për marrjen e masave kundër përdorimit të duhanit. Në këtë aspekt, ju falënderoj jashtë mase për të gjithë punën e mirë! Mendoj se është mirë që të vazhdoni me të njëjtin agresivitet, po përdor këtë fjalë, që ajo, për të cilën ne ndihemi mirë që u arrit, të vazhdojë me të njëjtat ritme dhe të zbatohet në të gjithë skajin e territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kështu, shumë faleminderit për informacionin, për statistikën dhe për trendin shumë pozitiv, sepse na keni bërë të ndihemi mirë për këtë pjesë! Gjithsesi, është mirë që të angazhohemi të gjithë dhe të bëhet një punë e përditshme, pa u stepur në asnjë moment, për të vazhduar zbatimin e ligjit deri në skajet më të largëta. Faleminderit!

Edlira Bode – Edhe unë dua të bëj një ndërhyrje të shkurtër. Në fakt, u bashkohem falënderimeve të të gjithë kolegëve, sepse fshati që duket, nuk do kallauz, pra kjo është një betejë në rrugën e duhur dhe ne jemi duke e fituar. Në gjykimin tim, nuk shkon çdo gjë vaj, sepse ka raste kur subjekte të caktuara, sidomos lokale të mëdha, kanë aktivitete të rëndësishme, kryesisht orëve të natës, të shoqëruar me të ftuar, me koncerte, ku ka një grumbullim masiv të të rinjve të cilët konsumojnë duhan. Çfarë parashikon ligji për këto raste

përsëritëse, përveç masës administrative? Edhe masa maksimale e ligjit për subjekte të tilla është e papërfillshme, e pallogaritshme. Pronarët apo administratorët e këtyre subjekteve nuk e kanë fare problem ta paguajnë gjobën, madje edhe shumë herë, mjafton që të lejojnë klientët e tyre të konsumojnë jo vetëm duhan, fatkeqësisht, por edhe drogë në raste të caktuara. A kemi në një mekanizëm kontrolli, apo një mënyrë për t'i frenuar, të paktën përsëritësit? Faleminderit!

Roland Xhelilaj – Kuptohet që lufta kundër duhanit, me gjithë rezultatet shumë të mira që kemi arritur, është e pambarimtë. Në qoftë se keni mundësi, dua të di shumë shkurt nëse jeni mbështetur në përvojat botërore, sepse kjo luftë nuk zhvillohet vetëm në Shqipëri, por kudo, sepse ne e shohim këtë gjë kur shkojmë jashtë vendit. Ato kanë një industri të fuqishme të duhanit, por edhe luftën kundër duhanit e kanë po kaq të fuqishme. A jemi mbështetur ne në këto përvoja dhe a mundet që disa elemente të tyre të bëhen pjesë e përpjekjeve, siç thatë edhe ju me të drejtë, për një promovim shumë të mirë, sidomos të moshat e reja? Ne bëjmë përpjekje nëpër shkolla, por rezultati nuk është aty ku duhet, por edhe promovimi nuk është në nivelin që të ndikojë pozitivisht te krijimi i opinionit antiduhan të moshat e reja. Faleminderit!

Elisa Spiropali – Zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli – Natyrisht që ne jemi mbështetur në përvojat botërore dhe kjo tregohet tek ajo që ju thashë, pra që kemi nënshkruar konventën dhe lufta po bëhet në bazë të parimeve të asaj konvente. Po kështu, edhe mënyra si po bëhet promovimi ka ngjashmëri me to, por edhe akciza është në përputhje me këto parime. Edhe kjo që po mendojmë të bëjmë tani, pra vënia e mesazheve fotografike në kutitë e duhanit po ndjek hap pas hapi atë lloj trendi.

Për sa i përket promovimit në shkolla, natyrisht që ky është një fenomen të cilin e kemi në vëmendje, madje aq shumë në vëmendje e kemi, sa edhe studimet i kemi bërë aty. Unë nuk dua të zgjatem, por dua të them se kemi bërë një studim nëpër shkolla për duhanin të fëmijët 11, 13 dhe 15 vjeç. Po ju them vetëm rezultatet e këtij studimi. Fatmirësisht, 90% e fëmijëve nuk kishin pirë asnjëherë duhan në jetën e tyre. Rreth 6% kishin pirë duhan ndonjëherë për ta provuar. Fatkeqësisht, 2% e rasteve e pinin rregullisht duhanin, pra bëhet fjalë për 15-vjeçarë. Nga kjo përqindje, 2,6% ishin djem dhe 0,8% ishin vajza. Natyrisht, rastet vinin duke u rritur nga 11 vjeç deri në 15 vjeç. Bërja e promovimit nëpër shkolla, pa dyshim që është një target i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, por, siç e shpreha në fjalinë e parë të këtij prezantimi, sfida në luftën kundër duhanit nuk është vetëm e sistemit shëndetësor, por është një sfidë, e cila prek shumë sektorë, pavarësisht funksionit që ne kemi.

Natyrisht, ajo që tha zonja Spiropali, në lidhje me gjërat që duhen bërë në mënyrë vizuale në shkolla, është shumë e rëndësishme. Në programet e shkollave, madje edhe në

programet për parashkollorët, janë futur materiale për luftën kundër duhanit, ku ka edhe materiale vizive. Për shembull, unë kam parë të ilustruar në libër një mushkëri me duhan dhe një mushkëri pa duhan, që është vërtet një gjë e frikshme për ata që e shikojnë. Pra, duhet ideja e pasjes së gjërave të qëndrueshme dhe jo vetëm mesazhet e sotme, si “Ndalohej duhani” apo “Jo duhanit”, e cila do të jetë një gjë shumë me vlerë, që duhet ta kemi parasysh.

Gjithashtu, e rëndësishme është edhe vendosja e posterave në mënyrë të qëndrueshme në qendrat shëndetësore. Natyrisht, në Ditën Botërore kundër Duhanit do t’i kemi, por, ndoshta, duhet të rifreskohen me figura, ku të tregohet realisht se çfarë pëson organizimi i njeriut, organe të ndryshme, nga pirja e duhanit.

Për sa i përket problemit të gjobave që ngriti zonja Bode, ky është një problem që e kemi diskutuar edhe me zotën Deda, sepse jemi gjendur përpara faktit që ka subjekte, të cilat janë gjobitur 9 herë. Pra, 9 herë kanë marrë gjoba të mëdha, të cilat i parashikon ligji, por përsëri vazhdojnë. Ju thashë që është ngritur një grup pune, i cili po shikon nëse ka vend për ndryshime në ligj dhe kjo do të jetë një nga ato pikat që do të diskutojmë, pra se çfarë do t’u bëhet këtyre subjekteve, sepse ne nuk kemi të drejtë t’ua mbyllim lokalit. Normalisht, këtu duhet të shkohet edhe drejt agresivitetit, siç propozoi zonja Xhembulla.

Bashkëpunimin me arsimin e shikoj shumë të rëndësishëm, sepse aty fillon... Fëmijët jo vetëm që nuk e përdorin vetë duhanin, por ndikojnë edhe te prindërit e tyre dhe bëjnë promocionin për të mos i lejuar ata të pinë duhan.

Për sa i përket bërjes së një promocioni më të madh në medie, natyrisht kjo qendron. Televizioni Shqiptar e ka në ligj këtë gjë. Ne nuk e kemi vlerësuar nëse e ka realizuar apo jo të plotë minutazhin. Në ligj nuk është përfshirë detyrimi që kanë televizionet private. Ndoshta, kur të rishikohet ligji, duhet parë edhe kjo gjë, pandaj duhet të jetë e gjithë shoqëria e përfshirë. Edhe vetë televizionet private duhet të jenë të përgjegjshme nga promocioni që bëhet. Lufta kundër duhanit është një luftë e përgjithshme, është një luftë që duhet të bëhet në çdo sektor. Në lidhje me problemin e rritjes së akcizës, pra se si ka ndikuar rritja e akcizës në lënien e duhanit, ky rezultat nuk është menjëherë i dukshëm. Ne presim që këtë rezultat ta shohim në vjeshtën e këtij viti, kur të dalin rezultatet e studimit. Gjithsesi, trendi duket pak edhe te sasia në rënie e duhanit të importuar.

Natyrisht që situata në periferi është ashtu siç thoni ju, sepse edhe vetë terreni është i tillë. Edhe ne vetë jemi të ndërgjegjshëm që, kur shkojmë nëpër rrethe, nuk shohim nëpër lokale atë frymën e moslejimit të duhanit. Kjo lloj tolerance shikohet që tek taketukja nëpër lokale, pra kjo tregon se edhe mund të lejohet diçka. Natyrisht, kjo është një sfidë. Shtimi i numrit të inspektimeve, të cilat unë i përmenda, vendosja e inspektimeve *online* dhe numri i tyre në rritje

tregojnë një trend rritës. Këto nuk janë ndryshime që ndodhin menjëherë, por janë ndryshime, të cilat bota ka kohë që i ka filluar. Edhe pse bota ka kohë që e ka filluar luftën kundër duhanit, përsëri duhani vazhdon të mbetet një problem.

E rëndësishme është që ne ta kemi në vëmendje, të mos kënaqemi me rezultatet që kemi arritur dhe të vazhdojmë të themi se kemi ende shumë për të bërë për të mbajtur këtë rezultat, sepse pak lëshohet dhe përsëri fillohet. Pra, për ta mbajtur këtë nivel duhet shumë, ndërkohë që duhet bërë edhe më shumë për ta çuar drejt minimizimit, pra për të arritur objektivin, të cilin e ka nënshkruar edhe parlamenti, që në vitin 2030 bota të jetë pa duhan.

Elisa Spiropali – Së pari, duhet të bindim disa anëtarë të parlamentit në kafënë e parlamentit. Na lind detyrimi që, së pari, të respektohet ligji aty, në sofrën parlamentare, pastaj të vazhdojmë me lokalet e periferisë.

Nëse nuk ka ndonjë çështje tjetër apo pyetje, ju falënderoj shumë për prezantimet dhe për punën tuaj!

Ditën e mirë!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA